



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0858**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenin 29 dhe 31 të Rregullorës së Punës së OSHP-se 01/ 2020, në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Inovix" SH.P.K, kundër Njoftimit për kontratë ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar për Repartin e Pediatriisë në Mitrovicë" me numër të prokurimit 206-23-10416-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, më 21/12/2023, mori këtë:

## Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e "Inovix" SH.P.K. me nr. 2023/0858, e datës 31/10/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar për Repartin e Pediatriisë në Mitrovicë", me numër të prokurimit 206-23-10416-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.
2. I lejohej autoritetit kontraktues të vazhdoj tutje me këtë aktivitet të prokurimit.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues është refuzuar si e pabazuar, të njëjtit i konfiskohet tarifa që ka paguar me rastin e parashtrimit të ankesës konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e RKS-së.

## Arsyetim

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 11.10.2023, Ministria e Shëndetësisë cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar për Repartin e Pediatriisë në Mitrovicë" me numër të prokurimit 206-23-10416-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 493,610.00€.

Me 25.10.2023, OE "Inovix Sh.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me datën 27.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka pranuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim ndërkaq ka vërtetuar vendimin e AK-së.

Me 31.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Inovix Sh.P.K.", me nr. Protokolli 858/23 lidhur me aktivitetin "Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar për Repartin e Pediatriisë ne Mitrovicë" me numër të prokurimit 206-23-10416-1-1-1".

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim:*

- "Sa i përket pretendimit për përshtatje të specifikave dhe kufizim të konkurrencës, lejohet (ose ekuivalent) ofertimi me produkte me specifika të njëjta ose me të avancuara. Për sqarimin tuaj, ky aktivitet është i një rëndësie të madhe, për shkak se është e rëndësishme që sa më shpejtë që kemi mundësi ta kompletojmë dhe funksionalizojmë Repartin e Pediatriisë në Spitalin e Përgjithshëm të Mitrovicës. Sa i përket pretendimit për mundësinë e keqpërdorimit të buxhetit të RK, nuk pajtohemi me këtë pretendim, duke marrë parasysh se specifikat teknike janë hartuar nga njohësit e lamisë, bioinxhinieret kompetent nga SHSKUK, të cilët kanë marrë parasysh të gjitha rrethanat, çmimet e tregut, ngritjet e çmimeve në treg viteve të fundit pas pandemisë, kostot e ngritura të transportit nga shtetet tjera, tarifat financiare dhe periudhën sa më të shpejtë për furnizim. Vlen të theksohet se bazuar në listën e fundit të AKPPM-se për Qarkulluesit me shumicë Për pajisje medicinale, kompania juaj nuk figuron fare në këtë listë si e regjistruar për qarkullim me shumicë pajisje medicinale dhe ju nuk mund të plotësoni kriterin baze të NJK dhe DT Kërkesa 3. Vetëm për Lot 1. operatori ekonomik duhet të dëshmoi se është i licencuar nga AKPPM si qarkullues me shumicë për pajisje medicinale (me validitet) - kopje. Në si AK po e marrim mundin që ta shqyrtojmë kërkesën tuaj për Rishqyrtim dhe ti trajtojmë pretendimet e juaja, edhe pse me vet faktin që nuk jeni i licencuar si qarkullues me shumicë për pajisje, këto pretendime janë të çuditshme për AK-MSh. Edhe në aktivitetet paraprake keni bërë ankesa të ngjashme, të cilat në i kemi shqyrtuar dhe i kemi marrë parasysh shumicën nga pretendimet e juaja, por në fund as që keni ofertuar fare në tender. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv."

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Inovix Sh.P.K." janë parashtruar si në vijim:*

- *Pretendimi i parë (I):* "Inovix Sh.P.K" si kompani e interesuar për pjesëmarrje ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-se lidhur me hartimin e specifikimit teknik të përshtatur pike për pike prodhuesve të caktuar, e që ka mundësuar pjesëmarrjen e vetëm një operator ekonomik që mund të plotësojë këto specifikime teknike. AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 28 duke hartuar specifikime të dukshme diskriminuese të cilat i kemi përshkruar me

detajisht mëposhtë. Njësia e kërkesës- Shkel Nenin 1,7 dhe 28 të LPP-se (Specifikime teknike favorizuese). Përpilimi i specifikimeve teknike të detyrueshme nga njësia e kërkesës për këtë aktivitet të prokurimit për pozicionet: 1. Hematologjik Crp që i është përshtatur pike për pike produktit BC-5130 i prodhuar nga prodhuesi Mindray, 8. Infusion Pump që i është përshtatur pike për pike produktit Agilia i prodhuar nga prodhuesi Fresenius kabi, 12. Light examination, Eëall mounted, adjustable Reflector me një drite me montim në muri që i është përshtatur pike për pike produktit LED 130 F të prodhuar nga prodhuesi Dr.Mach, 15. X-ray system digital – mobile Adult/Pediatric që i është përshtatur pike për pike produktit meX 40 të prodhuar nga prodhuesi Medical Econet, 24. Syringe Infusion Pump që i është përshtatur pike për pike produktit Agilia i prodhuar nga prodhuesi Fresenius kabi, 26. Ultrasound Scanner, Portable, General që i është përshtatur pike për pike produktit S8 Exp të prodhuar nga prodhuesi Sonoscape, 27. Pediatric-Adult Ventilator që i është përshtatur pike për pike produktit Tv-100 i prodhuar nga prodhuesi Bio-Med 28. Modular system for intensive care unit që i është përshtatur pike për pike produktit Agilia i prodhuar nga prodhuesi Fresenius kabi, 29. Ventilator Transportues që i është përshtatur pike për pike produktit TV-100 i prodhuar nga prodhuesi Bio-Med Devices, 30. Shtrat Transportues që i është përshtatur pike për pike produktit TM-C 3033 i prodhuar nga prodhuesi Turmed, 31. Analyzer For Blood Gases, Electrolytes And Metabolites që i është përshtatur pike për pike produktit EasyStat i prodhuar nga prodhuesi Medicacorp, 40. Defibrilator që i është përshtatur pike për pike produktit DefiMonitor XD i prodhuar nga prodhuesi Primedic, 44. Karroce për Bartjen e ushqimit që i është përshtatur pike për pike produktit Optima RS i prodhuar nga prodhuesi Burlodgeexport, 45. Karroce për Bartjen e ushqimit që i është përshtatur pike për pike produktit Optima RS i prodhuar nga prodhuesi Burlodgeexport. Të gjitha produktet e lartcekura i janë përshtatur pike për pike vetëm prodhuesve të lartcekur, gjë që e bën të pamundur që të ofrohen produkte ekuivalente me të avancuara.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Inovix Sh.P.K” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7,28 të LPP-së, si dhe nenin 20 paragrafi 3,4 të RRUOPP-së.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur në nenin 111 paragrafi 5 lidhur me nenin 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14.11.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe me datë 16.11.2023 ka autorizuar ekspertin teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0858/23, ndërsa me datë 27.11.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues si dhe ekspertit teknik me nr. 2023/0858 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.”

*Lidhur me pretendimet e OE “Inovix Sh.P.K” eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik përmes raportit nr. 2023/0858 ka vlerësuar si në vijim:*

- *Konstatimi i parë (I):* “ Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 206-23-10416-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 12.10.2023, me procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim. Kemi dërguar kërkesën tone për rishqyrtim tek AK Ministria e Shëndetësisë lidhur me specifikimet teknike ne DT te cilat i janë pershtatur pike për pike prodhuesve te caktuar dhe rrjedhimisht AK ka vepruar ne kundërshtim me Nenin 1, 7, 28. AK ka refuzuar kërkesën tone për rishqyrtim me datën 27.10.2023 si pjesërisht te bazuar pa ofruar sqarime me te detajuara. OE pas refuzimit te kërkesës për rishqyrtim nga AK, me datë 31.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, duke pretenduar se AK do të kufizoj konkurrencën lidhur me specifikimet teknike të kërkuara, duke shkelë nenin .....Tutje, OE ankuesi kërkon që mos ti përshtatet specifikave teknike për vetëm një OE pasi qe kjo është procedure e hapur dhe qëllimi i Autoritetit kontraktues sipas LPP-se është trajtimi i barabarte i OE dhe prodhueseve pjesëmarrës për te arritur qëllimin-Parimin e Ekonomicitetit. Andaj kjo arrihet vetëm kur termat teknike te jene minimal qe përfshijnë disa prodhues ne treg qe te mundësojnë konkurrence maksimale ne mes Operatoreve ekonomik. Eksperti teknik, pasi ka ekzaminuar dëshmitë e ofruara nga OE ankues vlerëson se kërkesa e OE është e bazuar, dhe se specifikimet teknike të hartohen ne atë mënyre qe te hapet konkurrenca për këto pozicione për arsye se specifikimet teknike nuk duhet të jenë favorizuese/diskriminuese për asnjë operator ekonomik, dhe si e tillë konsideroj se pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar..”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Inovix Sh.P.K.” .Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertëve. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Inovix Sh.P.K.” janë të bazuara.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, po ashtu edhe OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar nga ana e këtij Paneli.

Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertëve shqyrtues (profesional dhe teknik) janë dhenë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se kësaj ankese i ka paraprirë një kërkesë për ri-shqyrtim e paraqitur pranë AK, lidhur me këtë kërkesë është nxjerrë një vendim nga ana e AK duke ju përgjigjur pretendimeve ankimore më dt. 27.10.2023, me çrast këto pretendime ankimore i kualifikon si pjesërisht të bazuara duke lejuar që produktet të jenë ekuivalente, të njëjta ose më të avansuara.

PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim. Andaj përfundimisht PSH ka vendosur se, AK ka lejuar ekuivalencën dhe pajisjet me të avansuara, po ashtu, PSH e pati parasysh edhe përgjigjen e AK në kërkesë për ri-shqyrtim, ku e thekson faktin se ankuesi nuk figuron fare në listën e fundit të AKPPM për qarkulluesit me shumicë për pajisje medicinale që është kriteri bazë i njoftimit për kontratë dhe Dosje të Tenderit. Rrjedhimisht paneli shqyrtues nuk e mbështetet raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues teknik të caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tij i cili supozohet të jetë profesional nuk e ka mbështetur me asnjë argument/provë dhe nuk ka asnjë konstatim konkret se cili është diskriminimi nga ana e AK, si dhe duke mos argumentuar se eksperti shqyrtues e ka pasur parasysh secilin dokumentacion për këtë lëndë duke përfshirë edhe përgjigjen në kërkesën për ri-shqyrtim nga ana e AK.

*- Përfundim -*

Paneli shqyrtues konsideron se AK ka bërë përmirësimet dhe ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenet 7, 27 të LPP. Andaj, kthimi i sërishëm i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, pa fakte dhe prova dhe/ose pa bazë ligjore, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit

51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse. Po ashtu, të gjitha AK janë të obliguara që hartimi i specifikimeve teknike të jetë konform nenin 28 të LPP..

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - " Inovix " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: